



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 9
Prishtinë, më 22 Maj 2013, në orën 10:00, salla N-302
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Ramiz Lladrovci, Imri Ahmeti, Adem Grabovci, Bali Muharremaj, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: auditori i përgjithshëm, Lars Lage Olofsson; përfaqësuesit e kompanisë audituese „BDO Kosova”.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatorë; Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 17.04.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit të performancës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2012;
4. Diskutim rreth kronologjisë së projekteve të Ministrisë së Infrastrukturës, të cilat nuk janë audituar nga ZAP-i, përfshirë këtu edhe autostradën Morinë - Merdare.
5. Njoftimi me Raportin e Trupës punuese, lidhur me menaxhimin e sistemit të pasurisë;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Valbona Dibra - Propozoi që pika katër të hiqet nga rendi i ditës, për shkak se Komisioni ka në shqyrtim Raportin vjetor të ZAP-it, me pasqyrat e audituara financiare.

Ramiz Lladrovci – Përkrah propozimin e deputetes Dibra. Kërkoj mendimin e auditorit të përgjithshëm, sepse auditori ka deklaruar që kjo kontratë është nën hetim, dhe nëse është nën hetim, Komisioni nuk duhet të merret me këtë çështje.

Adem Grabovci – Çështja e shtruar në propozimin e rendit të ditës, në pikën e katërt, ka të bëjë me një projekt nacional dhe mediat si dhe qytetarët e interesuar kanë pasur qasje në këtë projekt, aq sa lejohet me ligj. Ky projekt nuk ka qenë asnjëherë sekret. Komisioni le ta votojë propozimin e deputetes Dibra dhe vota është ajo që vendos se si të veprohet.

Kryetari - Ishte i mendimit që Komisioni duhet ta shqyrtojë edhe pikën e katërt, sepse kjo është e përballueshme për Komisionin. Anëtarët e Komisionit do të njoftohen pse ka propozuar këtë agjendë. Anëtarëve të Komisionit do t'ju shpërndahet një material, i cili është kërkuar të jetë konfidencial, por ne sot do ta bëjmë publik.

Imri Ahmeti – Komisioni mund ta shtyjë diskutimin për këtë pikë, por kjo çështje duhet të diskutohet sot apo edhe në një mbledhje tjetër të Komisionit. Kjo nuk mund të shmanget dhe nëse nuk mund të shmanget, atëherë nuk ka arsye të mos diskutohet sot. Propozoi që kjo të mbetet në rend dite, pastaj nëse Komisioni nuk arrin ta përfundojë, mund ta lë për mbledhjen e radhës.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, me 5 vota për dhe 4 kundër, nxori këtë

Përfundim

Shtyhet diskutimi rreth kronologjisë së projekteve të Ministrisë së Infrastrukturës, të cilat nuk janë audituar nga ZAP-i, përfshirë këtu edhe autostradën Morinë – Merdare.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 17.4.2013

Kryetari- Konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, mbajtur më 17.04.2013.

3. Shqyrtimi i Raportit të performancës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2012

Kryetari - Raportit vjetor të performancës së ZAP-it, i janë bashkangjitur edhe PVF-të, të cilat janë audituar nga kompania audituese e përzgjedhur. Sipas raportit të ZAP-it, në sezonin e auditimit 2011/2012, janë kryer 101 auditime. Prej tyre të kontraktuara nga ana e ZAP-it ishin me operatorë të ndryshëm ekonomikë, 18 sosh apo rreth 20% të tyre. Një raport i auditimit të Buxhetit të Kosovës, 87 auditime të rregullsisë, 2 auditime të performancës, 8 auditime menaxheriale, 3 auditime të fondit të donatorëve.

Ndërsa, për sezonin e auditimit 2012/2013, planifikohen të bëhen 113 auditime, prej të cilave 9 auditime të performancës. Krahasuar vitin 2011, me vitin 2012, ZAP-i ka arritur të shtojë numrin e auditimeve për 12 sosh. Gjatë sezonit të auditimit 2011/2012, opinionet e dala nga këto auditime janë: 35 opinione të pakualifikuara, 32 opinione të pakualifikuara me theksim të çështjes, 15 opinione të kualifikuara, 4 opinione të kulifikuara me theksim të çështjes, 0 opinione të kundërta, 3 mohime të opinionit.

Krahasuar me opinionet e dhëna nga viti i kaluar, këtë vit kemi progres në këtë fushë, ku nga 15 opinione të pakualifikuara në vitin e kaluar, këtë vit kemi 35, si dhe nga 3 opinione të kundërta, këtë vit nuk e kemi fare këtë opinion. Gjithashtu, 9 opinionet nga viti i kaluar si mohim opinionit, ndërsa këtë vit i kemi vetëm 3. Po ashtu, gjatë auditiveve, janë dhënë 590 rekomandime, prej tyre 366 për nivelin qendror, ndërsa 224 për nivel lokal. Prej tyre ishin adresuar plotësisht 185 apo 31%, të adresuara pjesërisht 208 sosh apo 35%, ndërsa të pa-

adresuara 34% e tyre. Dukuri kjo mjaft shqetësuese me rastin e mosadresimit të rekomandimeve nga ana e organizatave buxhetore.

Niveli i shpenzimit vjetor është prej 1.822 milion euro apo 94.1% e buxhetit vjetor në total, të të gjitha kategorive ekonomike. Paga dhe mëditje 1.215 milion euro apo 62.7% e buxhetit. Mallra dhe shërbime 0.622 milion euro apo 32% e buxhetit, shpenzimet komunale 0.04 milion euro apo 2.0% e buxhetit, shpenzimet kapitale 0.06 milion euro apo 3% e buxhetit. ZAP-i ka paraqitur shpenzimet për kode ekonomike, si shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet për trajnime shpenzimet për auditimet e kontaktuara, mirëmbajtja e objektit, sigurimi i veturave etj. dhe pothuajse përqindja më e madhe shkon në shpenzimet e pagesë për qira apo 33% e buxhetit të shpenzuar në kategorin e mallrave dhe shërbimeve.

Po ashtu, ZAP-i në raport ka paraqitur edhe çështjen e burimeve njerëzore, nga 142 të punësuar në ZAP për vitin 2012, 28 prej tyre janë staf administrativ, ndërsa 114 staf auditues. Gjatë vitit 2012, ZAP-i ka rekrutuar stafin prej 18 pozitave, ndërsa në këtë numër është përfshirë edhe pozita e zëvendësauditorit, prej tyre 8 ishin të punësuar si zëvendësues të stafit aktual. Gjatë vitit 2012, ZAP-i kishte tetë procese të rekrutimit, prej 1035 kandidatë që kishin shprehur interesim dhe nga kjo janë intervistuar vetëm 99 kandidatë. Nga ankesat e kandidatëve, dy lëndë janë drejtuar në KPMSHC, ku kjo e fundit ka vendosur në favor të ZAP-it. Numri i auditorëve të certifikuar është 25, një rritje për 1 auditor nga viti i kaluar, 29 kontabilistë të certifikuar, 28 teknikë kontabiliteti, 14 auditorë për trajnim, 8 auditorë të performancës dhe 1 auditor i brendshëm.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i Kuvendit të Republikës së Kosovës, së bashku me Zyrën e Prokurimit të Kuvendit, ka bërë përzgjedhjen e kompanisë „BDO Kosova” për të bërë auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të ZAP-it për vitin 2012. Sipas raportit të dorëzuar nga kompania „BDO Kosova”, për ZAP-in janë adresuar disa të gjetura. Menaxhimi i kontratave, blerjet me procedurë të kuotimit për furnizime identike, harmonizimi i regjistrimit të aseteve mbi 1 mijë euro në mes modulit të regjistrimit të pasurisë dhe SIMFK, mungesës së nënshkrimeve në format standarde të raportit të pranimit të mallrave dhe shërbimeve.

Koment i përgjithshëm - Në përgjithësi, të gjitha rekomandimet e dala nga kompania audituese „BDO Kosova” për auditimin e PVF të ZAP-it për vitin 2012, në një formë apo tjetër, nuk janë konstatuar shkelje materiale, në përjashtim të shkeljeve procedurale.

Burim Cena, përfaqësues i kompanisë „BDO Kosova” - Kompania ka bërë auditimin e PVF të ZAP-it, se a janë në harmoni me standartet ndërkombëtare financiare. Ne kemi hartuar dy raporte, njëri ka të bëjë me të gjeturat në PVF të ZAP-it, ndërsa tjetri ka të bëjë me letërmenaxhmentin e ZAP-it. Ashtu siç është paraqitur në raport, përveç gabimeve teknike, nuk ka pasur shkelje të natyrës materiale në raportin e PVF të ZAP-it.

Lars Lage Olofsson- Të gjeturat e kompanisë audituese në PVF, nuk janë të lidhura drejtpërsëdrejti me ZAP-in. Ato më tepër janë si rezultat i mangësive që ka sistemi mbi regjistrimin e pasurisë, si dhe udhëzimi administrativ 21/2009 i Ministrisë së Financave mbi regjistrimin e pasurisë. Një situatë e ngjashme është në të gjitha organizata buxhetore, për këtë është njoftuar disa herë edhe në komisionin e juaj.

Ramiz Lladrovci – Pyeti përfaqësuesin e kompanisë audituese se pse nuk ka bërë ndonjë koment sa i përket stafit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i rregullsisë përshin edhe këtë çështje.

Burim Cena, përfaqësues i kompanisë „BDO Kosova” - Ne kemi bërë vetëm pjesën e auditimit të PVF-ve të ZAP-it, pa u lëshuar në çështjen e personelit apo të ngjashme, ndërsa kjo sepse kemi pasur fushëveprimtarinë e kufizuar.

Valbona Dibra- ZAP-i ka dorëzuar raportin, ashtu siç kërkohet me legjislacionin në fuqi. Në raport, në faqe 6 thuhet se KMFP i shfrytëzon raportet e ZAP-it. Kjo nuk tingëllon mirë, sepse

KMFP i shqyrton raportet, e jo i “shfrytëzon”, siç thuhet në raport. Po ashtu, tek llogaridhënia thuhet se ZAP-i ka përgatitur me kohë dhe ka njoftuar KMFP-në mbi funksionimin dhe menaxhimin e vet ZAP-it. Kjo është për t’u përsëritur, sepse vet auditori i përgjithshëm ka pranuar se është përgjegjës para Komisionit.

Planifikimi i auditimeve të performancës është në rritje, kërkesë kjo edhe e KMFP. Pyeti: Pse Raporti i performancës mbi kontrollin e sigurisë së ushqimit dhe Raporti mbi inspektimin e barnave, nuk kanë ardhur në KMFP, arsyeja? Po ashtu, në planifikim të auditimeve për vitin 2012/2013, 9 prej auditimeve janë të performancës. Auditimet e përzgjedhura nga ZAP-i janë të vështira, për shkak të specifikave, p.sh. auditimi i mbetjeve spitalore. Është në rënie numri i kompanive audituese të kontraktuara për auditim të institucioneve buxhetore. Në raport, shumë pak është shënuar për punën e auditorit të brendshëm të vetë ZAP-it, kur dihet rëndësia e pozitës së tij.

Opinionit i ZAP-it në PVF të audituara nga kompania audituese, është i mirë dhe për këtë e përgëzoj menaxhmentin e ZAP-it. I propozoi Komisionit që t’i rekomandojë Kuvendit që vitin tjetër të bëhet një auditim i performancës së ZAP-it, për vitin 2012/2013.

Imri Ahmeti- Bazuar në raport, thuhet se kemi rritje të numrit të auditimeve, në të njëjtën kohë edhe të numrit të rekomandimeve. Shqetësues është fakti se numri i moszbatimeve të rekomandimeve, janë të larta prej 187 rekomandimeve dhe në anën tjetër thuhet se performanca është në rritje. Mendoj se këtu esenciale është cilësia e auditimeve nga vlerësimi i vet ZAP-it, e jo vlerësimet e dhëna nga institucionet ndërkombëtare. Po ashtu, raporti është i ngarkuar së tepërmi me fotografi, që për mendimin tim kanë qenë të panevojshme.

Mursel Haljilji- Pyeti, se cila është cilësia e raporteve të auditimi, bazuar në raportet e publikuara nga ZAP-i. Po ashtu, është e rëndësishme edhe përcjellja e zbatimit të rekomandimeve nga ana e ZAP-it. Në raport shihet se kemi rritje të numrit të auditimeve nga viti në vit, mirëpo si qëndron situata me cilësinë tyre, me kusht që KMFP të ketë një pasqyrë më reale.

Adem Grabovci – Shqetësimi ynë është në përgatitjen e stafit të ZAP-it. Po ashtu, bazuar në raport, kemi rritje të opinionëve të mira, krahasuar me vitet paraprake: 35 opinionëve të pakualifikuara, 32 opinionëve të pakualifikuara me theksim të çështjes, 15 opinionëve të kulifikuara, 4 opinionëve të kulifikuara me theksim të çështjes, 0 opinionëve të kundërta, 3 mohime të opinionit dhe ka një dallim të madh me vitin 2011.

Bali Muharremaj- Është shqetësues moszbatimi i rekomandimeve të ZAP-it, mirëpo kjo në disa raste arsyetohet, për shkak të mosadresimit të qartë të rekomandimeve. Pyeti: A është kjo për shkak të paaftësisë së stafit të ZAP-it për mosdhënien e rekomandimeve të qarta dhe specifike? ZAP-i, po ashtu, ka një plan të rritur të auditimeve të performancës, mirëpo në fund të vitit, finalizimi i tyre po mungon. Cili është sqarimi i ZAP-it për këtë?

Ramiz Lladrovci- Pyeti: Cila është strategjia 5 vjeçare e ZAP-it në kontest të përgatitjes së stafit? Po ashtu, numri prej 197 rekomandimeve të adresuara është numër i madh, mirëpo mendoj se adresimet janë të ngjashme për shumicën e organizatave buxhetore.

Afrim Hoti – Pyeti: Pse testi për rekrutim të stafit është hartuar në gjuhën angleze për kandidatët dhe nuk është hartuar në gjuhën shqipe, kur dihet se Kosova ka gjuhë zyrtare gjuhën shqipe? Cili është bashkëpunimi i ZAP-it me Prokurorinë dhe gjyqësorin?

Lars Lage Olofsson - Auditorët e jashtëm kanë kontrolluar disa procese të rekrutimit. Ata kanë parë procesin e rekrutimit të auditorit të përgjithshëm dhe të tjerëve dhe nuk kanë dhënë ndonjë koment, kjo është e sigurt.

Po e filloj me atë që nuk jam i kënaqur me këtë raport dhe kjo ka të bëjë me tabelën numër 4 në lidhje me rekomandimet për faktin se ne japim opinionëve për vitin e mëparshëm në qershor, pas

një muaji ne e marrim një plan veprimi për adresimin e tyre, dhe në shumë raste, institucionet e audituara vijnë në këtë Komision dhe kërkohet llogari prej tyre, pastaj ne kur e kryjmë auditimin e ndërmjetëm nga shtatori e më tutje, ka shumë pak rekomandime të cilat kanë dalë dhe kanë mundur të bëjnë diçka, sepse për këtë kërkohet më shumë kohë dhe rekomandimet në këtë tabelë, janë rekomandime për vitin 2010. Pas disa javësh dhe sigurisht në raportin vjetor të auditivit, i cili do të publikohet më vonë, ju do të shikoni se si janë trajtuar këto për vitin 2011. Në buxhetin e vitit 2010, ne nuk kemi paraqitur në përdorim auditim e pasqyrave 9 mujore financiare. Ne jemi munduar që organizatat buxhetore ta bëjnë hartimin e këtyre pasqyrave financiare, në mënyrë vullnetare. Ata refuzuan, sepse thanë që nuk ishte një obligim ligjor dhe për këtë ne biseduam dhe e bindëm ministrin e Financave, që ta bënte këtë si obligim ligjor dhe kjo është diçka shumë e rëndësishme të cilën e kemi bërë. Pra, tabela 4 është një tabelë e vjetër për mua, pasi nuk është azhurnuar mjaftueshëm, por mendoj që në ditët e sotme situata është më e mirë. Kemi arritur me trajnimet dhe përgatitjen e stafit për të ardhmen. Kemi njerëz që kanë filluar të punojnë tek në vitin 2004, si dhe njerëz që kanë filluar të punojnë në vitin 2013. Dhe, neve na duhet t'i trajtojmë këta njerëz në mënyra pak më të ndryshme, për shkak të aftësive të tyre. Edukimin e tyre dhe përvojat e tyre të ndryshme, duhet filluar nga kontrolli i pajtueshmërisë, auditimi, puna në qeverisjen e mirë. Pra, ajo se çka kemi flijuar edhe ajo çka do të fillojmë që ta përdorim në qershor edhe korrik, është faktikisht si vendi i parë në botë, është pra skema e certifikimit, e cila është plotësisht në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të institucioneve të zyrës së auditimit dhe çdokush në zyrë do të kalojë në pjesët relevante të kësaj skeme dhe aty ekziston baza profesionale. Kjo nënkupton që ata duhet të njohin, si përmbajtjen, ashtu edhe teknikat në sektorin publik dhe kjo është shumë e rëndësishme për ne, sepse skemat e certifikimit që i kemi pasur deri më tani, kanë qenë të përcaktuara nga kërkesat e tregut privat. Kuvendi do të tregojë maturitet, në mënyrë që të vendos pikat e tij dhe kur do të takojë auditorin e përgjithshëm, i cili do të jetë vërtet i pavarur nga interesat e ndryshme. Ajo çka ne kemi punuar shumë, është sigurisht që kemi një ligj i cili është në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe i jep një pavarësi të plotë auditorit të përgjithshëm. Ky Ligj është duke u diskutuar në komisionin e Ministrisë së Financave dhe shqetësimet më të mëdha janë duke u bërë për trajtimin e shërbyesve civilë, për sa i përket auditimeve të performancës.

Arsyja pse ju keni marrë vetëm dy raporte të performancës dhe një raport menaxherial të vitit të kaluar, është shumë e thjeshtë, për faktin se ato nuk ishin shumë mirë të përgatitura për t'u raportuar. Ne kemi një marrëveshje bashkëpunimi me Zyrën e Auditimit të Suedisë, e cila vazhdon bashkëpunimin, që do të jetë deri në qershor të vitit 2016, si dhe një projekt i binjakëzimit që do të jetë deri në vitin 2015. Një fond nga Banka Botërore, i cili është për t'u shqyrtuar se si merren vendimet e punës nga ana e prokurimit. Derisa unë të jem këtu, ne do të ndalojmë kontraktimin e auditimit të komunave.

Auditimi i brendshëm, 5 apo 6 procedurat e prokurimit, procedurat e burimeve njerëzore, në shumicën e rasteve, këto procedura janë ndryshuar gjatë kohës dhe të gjitha këto kanë pasur të bëjnë me mënyrën sesi të azhurnojmë apo t'i përmirësojmë proceset e vonshme, si dhe përmirësimin e doracakut të brendshëm administrativ. Mënyrën sesi ta trajtojmë atë për sa i përket rekrutimit, nuk e di ku e keni marrë këtë informacion! Kërkesat tona themelore janë se njerëzit duhet të jenë të aftë të shkruajnë dhe të flasin në gjuhën shqipe dhe kjo është një kërkesë. Gjithashtu, kandidatët duhet të jenë të aftë të flasin edhe serbishten, si dhe të jenë të aftë që të komunikojnë edhe në gjuhën angleze për disa pozita specifike. Në zyrën tonë është absolutisht e nevojshme që stafi të jetë i aftë të lexojë në gjuhën angleze. Njëra nga çështjet strategjike që është përmendur edhe këtu është diçka shumë e rëndësishme për Kosovën dhe ajo është delegimi i fondeve, pra trajtimi i tyre në sistemin tonë. Nuk ka mundësi që të gjitha dokumentet e diskutimet me Bashkimin Evropian të përkthehen në gjuhën shqipe. Kosova nuk mund të përballojë këtë dhe të njëjtën situatë e kemi edhe me disa institucione tjera, sa i përket cilsisë së trajnerëve.

Sa i përket fotografisë, është diçka për të cilën mund të mendosh dhe menaxhimi i stafit nuk është një çështje e madhe për neve. Ne po punojmë me të në mënyra të ndryshme. Kemi pasur disa shqetësime lidhur me artikujt nëpër gazeta, mirëpo këto tani janë rregulluar.

Deri më tani i kemi publikuar 11 raporte dhe do të kemi edhe të tjera. Gjithashtu po punojmë me të gjithë stafin tonë se çka është e nevojshme për auditorin modern në sektorin publik, por nuk është thjeshtë për të kryer një detyrë teknike, në një perspektivë me pajtueshmërinë. Mendoj se rekomandimi i deputetit Mursel, është me vend, sepse ne duhet t'i ndjekim rekomandimet jostatusore. Ne jemi munduar ta bëjmë këtë, por duhet të lëvizim me një mënyrë më të organizuar. Sa i përket strategjisë time 5 vjeçare, lidhur me pyetjen e deputetit Ramiz, ne jemi duke azhurnuar strategjinë tonë zhvillimore. Ajo përfshin strategjinë dalëse, ligjin e ri, zbatimin e atij ligji, legjislacionin sekondar, shqyrtimi i standardeve evropiane, testimi i makinerisë ku unë delegoj detyrat deri tek niveli më i ulët.

Valbona Dibra- Duke ju referuar raportimit të auditorit të përgjithshëm, sipas të cilit: *“Auditorët e jashtëm kanë kontrolluar disa procese të rekrutimit, ata kanë parë procesin e rekrutimit të auditorit të përgjithshëm dhe të tjerëve dhe nuk kanë dhënë ndonjë koment kjo është e sigurt”*. Lidhur me këtë, pyeti përfaqësuesit e kompanisë “BDO Kosova”: Pse nuk kanë prezantuar në raport një gjë të tillë?

Burim Cena, përfaqësues i kompanisë “BDO Kosova”- Nuk kemi pasur fushëveprim për një gjë të tillë. Ne posedojmë kontratat, për të cilat kemi qenë të angazhuar nga Kuvendi.

Ramiz Lladrovci- Kompania nuk ka qenë e kufizuar për të kryer punën e saj edhe sa i përket pjesës së stafit. Aq më tepër, kur auditori e konfirmoi se kjo kompani ka kontrolluar këto procese, por në raport të BDO-së, nuk figuron diçka e tillë. Pjesë e raporteve të rregullsisë, përpos pjesa e prokurimit, përfshihet edhe pjesa e stafit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri vendosi që Kuvendit t'i

Rekomandojë:

- 1. Të miratohet Raporti vjetor i performancës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, me pasqyrat e audituara financiare për vitin 2012.**
- 2. Kuvendi i Kosovës të angazhojë një kompani audituese, e cila do të bëjë auditimin e performancës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012 dhe 2013.**

4. Njoftimi me Raportin e Trupës punuese, lidhur me menaxhimin e sistemit të pasurisë

Kryetari- Siç jeni në dijeni, në Kosovë operojnë dy sisteme mbi regjistrimin e pasurisë në MAP dhe MF. Në një takim të KMFP-së, ne kemi kërkuar të themelohet një grup punues për unifikimin e këtyre sistemeve. Një raport kthyes është dorëzuar nga Ministria e Financave në KMFP, me të cilin na informon se është themeluar grupi dhe se është duke u punuar në evitimin e problemeve në modulën e regjistrimit të pasurisë. Po ashtu, ne do të kerkojmë që para datës 30 qershor 2013, MF dhe MAP të dorëzojnë raportin lidhur me progresin e arritur në avancim të sistemeve.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri ka vendosur që Ministrisë së Financave, Ministrisë së Administratës Publike dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm t'u

Rekomandojë:

- 1. Trupa punuese lidhur me trajtimin dhe zgjidhjen e çështjes së menaxhimit të pasurisë, të ndërmarrë veprime konkrete, lidhur me adresimin e kësaj çështjeje.**

2. *Ky trup punues, deri në fund të muajit qershor 2013, me raport me shkrim ta njoftojë Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje.*

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu